



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

*Rr. "Adem Jashari" nr.1, Tel.028/571-524, Fax 028/571-232, E-mail: sekretaria\_kkvush@yahoo.com*

Në bazë të nenit 31.2 pika "0" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më, 25.03.2010 mori këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për ndarje të bursave**

**Neni 1.**

Me këtë vendim formohet komisioni për ndarje të bursave për student të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2009/2010.

**Neni 2.**

Komisioni ka këtë përbërje:

- 1. Selim Rrustemi**
- 2. Qazim Azemi**
- 3. Vlora Qirezi**
- 4. Qerim Selimi**
- 5. Musli Melenica**

**Neni 3.**

Komisioni i cekur ka për detyrë që të zhvilloj procedurat për ndarje të bursave për student të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2009/2010 në bazë të konkursit të shpallur të Drejtorisë Komunale të Arsimit 10 Nr.397 të 23.09.2009.

**Neni 4.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisiont të cilët do të veprojnë konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 5.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit në mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

---

Bazuar në nenin 12 dhe 40 par. 2 “a” dhe “g” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 31.2 “g” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.03.2010, mori këtë:

**V E N D I M**

Neni 1.

Me këtë vendim ndryshohet Rregullorja për Tarifa Ngarkesa dhe Gjopa Komunale 01Nr.742/08, dt. 30.12.2008.

Neni 2.

2.1. Teksti i pikës 1.14 të paragrafit 3.1 të nenit 3 të rregullores, ndryshohet dhe duhet të jetë: Vërtetimi (identik me origjinalin) për një akt-kopje, 0.50 €.

2.2. Fshihet pika 1.19 i paragrafit 3.1, nga neni 3 të rregullores e cila ndryshohet.

Neni 3.

3.1. Ndryshohet paragrafi 3.2 i nenit 3 të rregullores, e që duhet të jetë: Nga pagesa për shërbimet e kryera prej pikës 1 – 19 të paragrafit 3.1 të nenit 3 të rregullores e cila ndryshohet, lirohen: shfrytëzuesit e ndihmës sociale, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, invalidët civil, të hendikepuarit, anëtarët e ngushtë të viktimave të luftës së UÇK-së (bashkëshorti-ja, fëmijët dhe prindërit e tyre).

3.2. Kategoritë e cekura si në paragrafin paraprak nuk lirohen për shërbimet nga pika 1,3 dhe 1.10 të paragrafit 3.1 të nenit 3 të rregullores së ndryshuar.

Neni 4.

4.1. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Administratë – Sektori i statusit civil.

Neni 5.

5.1. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi